

Problematika e standardeve të zgjedhjeve në 11 maj 2025

Rekomandimet e fokus grupit me aktorët civilë

Maj 2025

Ky raport u zhvillua në kuadër të projektit “Partneritete të forta për reforma të qëndrueshme - Forcimi i rolit të shoqërisë civile në adresimin e sfidave të zgjedhjeve të lira dhe të drejta”, mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulta përmes programit MATRA. Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi vetëm e ekipit realizues të APS & IPS dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e ambasadës.

AKADEMIA E STUDIMEVE POLITIKE
Rr. Emin Duraku, Pallati Credins, kati 7, Tiranë
Tel: +355 4 5629047, E-mail: info@asp.al
Web: www.asp.al

INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE
Rezidenca "Garden Side", Rr " Faik Konica", Kati
1, Ap. 3, Tiranë Email: contactaips@isp.com.al
Web: www.isp.com.al

HYRJE

Zgjedhjet e 11 majit 2025 u zhvilluan në mungesë të një reforme thelbësore zgjedhore dhe përsëritën problematikat e konstatuara në raportet e mëparshme të shoqërisë civile dhe monitoruesve ndërkombëtarë. Pas më tepër se dy viteve diskutimeve mbi një reformë zgjedhore, në korrik 2024, Kuvendi miratoi disa ndryshime të rëndësishme, por minimaliste në Kodin Zgjedhor, pa iu nënshtruar procesit ligjor të konsultimit publik. Disa nga këto ndryshime vlerësohen pozitive, veçanërisht eliminimi i pragut për kandidatët e pavarur, ndalimi i kandidimit të liderëve partiakë në disa qarqe dhe specifikimet për votën nga jashtë.

Megjithatë, mbetën të paadresuara problematikat e konstatuara në raportet e mëparshme të si shitblerja e votës, intimidimi i zgjedhësve, garantimi i fshehtësisë së votimit, depolitizimi i administratës zgjedhore dhe transparenca e financimit të fushatës.

Në përfundim të procesit zgjedhor dhe kur vijojnë të rinumërohen votat e disa qendrave zgjedhore, Instituti i Studimeve Politike dhe Akademia e Studimeve Politike, organizuan një takim të një fokus grupi me 15 përfaqësues të shoqërisë civile, akademikë, gazetarë dhe studentë aktivë. *(Lista e pjesëmarrësve në shtojcën 1).*

Diskutimi u fokusua në raportet e hartuara nga ekspertët e dy organizatave gjatë dy viteve të fundit në kuadër të punimeve të komisionit të posaçëm parlamentar të reformës zgjedhore, në aspekte të standardeve zgjedhore. Pjesëmarrësit sollën eksperiencat e tyre gjatë fushatës dhe ditës së zgjedhjeve si dhe opinionet e tyre për çështjet kryesore të identifikuar si problematike dhe me ndikim në përfaqësimin politik.

Më poshtë renditen disa prej çështjeve kryesore të identifikuar si të rëndësishme për standardet dhe që kërkojnë trajtimin e duhur nga reforma e ardhshme zgjedhore:

- Sistemi zgjedhor – Vota preferenciale dhe listat e mbyllura;
- Administrimi i zgjedhjeve – Depolitizimi i trupës zgjedhore
- Fushata elektorale dhe përdorimi i burime shtetërore;
- Votimi nga jashtë vendit;

Propozimet dhe opinionet e shprehura në takim synohet të bëhen pjesë e dokumenteve rekomandues në vijim të angazhimit të deritanishëm në kuadër të projektit për rritjen e transparencës dhe angazhimit të publikut në reformat zgjedhore.

ÇËSHTJE PËR DISKUTIMIN E FOKUS GRUPIT

Votimi preferencial - Listat e mbyllura dhe të hapura

Pas një marrëveshjeje midis dy partive më të mëdha, krahas listave ekzistuese të votimit preferencial, u testua në zgjedhjet e 11 majit edhe komponenti i listave të mbyllura. (1/3 e kandidatëve në çdo zonë). Gjykata Kushtetuese e rrëzoi ankesën e disa partive më të vogla, përfshirë disa që përfaqësojnë pakicat, duke deklaruar se sistemi ishte në përputhje me Kushtetutën. Sistemi i ri konsiderohet një hap përpara, por ende i jep liderit të partisë kontroll të konsiderueshëm mbi renditjen përfundimtare, sidomos për vendet e sigurta.

Problematika

- Përzgjedhja e kandidatëve për deputetë, domain i kryetarëve dhe mungesa e mekanizmave realë të konkurrencës. PS nuk organizoi zgjedhje të brendshme apo procese konsultimi me bazën për përzgjedhjen e kandidatëve, ndërsa PD ndërmoi një proces primaresh, i cili në shumë raste u anashkalua apo u deformua.
- Rivaliteti mes kandidatëve në listë të hapur. Votuesit u gjenden nën tryzni për të zgjedhur edhe mes të njëjtës forcë politike, ndërkohë që rezultatet e larta të disa kandidatëve ngrenë dyshime për votim të orientuar nga drejtuesit politikë drejt kandidatëve të caktuar.

Rekomandime / Opinione

- Disa parti politike dhe grupe të shoqërisë civile kanë iniciuar nisma për kalimin 100% me sistem proporcional me listë të hapur. Jeni dakord me këtë propozim?
- A mendoni se renditja në listat e hapura apo të mbyllura është një zhvillim që ndihmon në përmirësimin e cilësisë së kandidatëve fitues?

Depolitizimi i administratës zgjedhore

Depolitizimi i administratës zgjedhore është një rekomandim i hershëm i OSBE-ODIHR si një mundësi për të përmirësuar standardet e zgjedhjeve në Shqipëri. Në marrëveshjen politike të 5 qershorit 2020, u dakordësua nga mazhoranca dhe opozita jetësimi i këtij depolitizimi në zgjedhjet e vitit 2025.

Marrëveshja parashikonte një formulë mikse të administrimit të procesit ku peshën kryesore teknike në komisione dhe grupet e numërimit i besojë punonjësve të shërbimit publik ndërsa

roli i përfaqësuesve të partive politike reduktohej vetëm në monitorimin dhe kontestimin e procesit.

Problematikat e konstatuara nën administrimin politik

- Ndikimi politik që sjell tensione dhe konflikte mes komisionerëve; interpretime të kundërta për të njëjtat procedura teknike; urdhëra për bllokimin apo vonesa të qëllimshme të procesit.
- Vonesat në propozimet e kandidatëve nga subjektet politike dhe zëvendësimet e shpeshta pas nisjes së detyrës ndikojnë në nivelin e trajnimit dhe përgatitjes të komisionerëve.
- Vështirësi për të gjetur njerëz të kualifikuar në zonat rurale për shkak të migrimit apo pamundësisë të angazhimit për shkak të punësimit në administratën lokale.

Rekomandime nga raportet ISP/ASP

Një administratë publike profesionale dhe larg presioneve për t'u përfshirë në fushata politike mbetet kushti kryesor për të siguruar klimën e duhur të besimit për funksionimin e një depolitizimi të trupës zgjedhore.

Kritikat kryesore vijnë në drejtim të konkurseve të rekrutimit dhe sistemit të vlerësimit dhe karrierës në administratën publike. Për më tej, format e patronazhimit ndaj administratës për të nxitur "pëlqimet" apo ndarjet e aktiviteteve politike të mazhorancës gjatë fushatave zgjedhore të fundit mbeten gjithashtu shqetësim për krijimin e një besimi të duhur ndaj administratës shtetërore.

Disa rekomandime të mëtejshme në drejtim të forcimit të besimit tek angazhimi i administratës publike janë:

- Funksionimi i mekanizmave të kontrollit të opozitës ndaj funksionarëve të administratës gjatë fushatës zgjedhore. Ekzistenca e një strukture apo komisioneri të monitorimit të administratës nga radhët e opozitës mund të sigurojë më shumë besim për mbarëvajtjen e procesit, por edhe mospërdorimin më të gjerë të burimeve shtetërore në fushatë.
- Hetimi dhe vendimmarrja e shpejtë e KQZ për të zëvendësuar nga detyra zgjedhore zyrtarët shtetërore të denoncuar nga opozita dhe organizatat e tjera si të përfshirë në fushatën zgjedhore të kandidatëve politikë.
- Trajnimi dhe certifikimi për administrimin zgjedhor për punonjësit e administratës nevojitet të jetë i detyrueshëm dhe të bëhet një nga kushtet për ecurinë në karrierë.

- Ngritja e një qendre trajnimi të vazhdueshëm pranë KQZ dhe regjistri kombëtar të punonjësve publikë të certifikuar për të ndjekur kualifikimin dhe vlerësimin në proceset zgjedhore të këtyre punonjësve publikë.
- Parashikimi i masave penalizuese në karrierë dhe vijimin e detyrës në rast të braktisjes së detyrës zgjedhore, përfshirjes në shkelje të ndryshme apo çdo formë tjetër abuzimi politik.

Votimi nga jashtë vendit

Votimi i diasporës ishte një nga risitë e zgjedhjeve të 11 majit dhe një arritje e përpjekjeve disa vjeçare të organizatave që përfaqësonin këtë pjesë të rëndësishme të popullsisë. Në vitin 2020, sipas INSTAT, numri i qytetarëve shqiptarë që jetonin jashtë territorit të Shqipërisë, apo diaspora shqiptare, përllogaritej të ishte 1.68 milionë persona apo rreth 37% e shqiptarëve në Regjistrin Civil.

Ndryshimet e korrikut 2024 në Kodin Zgjedhor përcaktuan se Komisioni Rregullator i KQZ-së duhet të miratonte aktet nënligjore deri më 15 nëntor 2024. Pavarësisht mungesës së kuadrit të plotë ligjor dhe debateve politike mbi ndryshimet e nevojshme ky proces u përmbyll me vonesë të konsiderueshme, vetëm më 20 mars 2025.

Problematikat

Për votuesit jashtë vendit, procesi i regjistrimit paraqiti sfida të konsiderueshme. Nga totali prej 365.166 kërkesa për regjistrim nga diaspora të kryera nga 294.155 zgjedhës, u regjistruan si votues nga jashtë 245.975 zgjedhës, dhe u refuzua kërkesa për 48.180 zgjedhës. Gjashtë qytetarë u regjistruan pas ankimit në gjykatë.

Procesi i shpërndarjes së fletëve të votimit nga kompania private DHL, u shoqërua me denoncime për parregullsi si mosdorëzimin personal të zarfeve, zarfe pa fletë votimi, probleme komunikimi me kompaninë dhe si pikë më e kundërshtuar nga opozita, nënkontraktim të paautorizuar të një operatori tjetër në Greqi.

Për të adresuar situatën, KQZ krijoi një mekanizëm raportimi në PER dhe i kërkoi kompanisë postare sqarime zyrtare. Me gjithë sfidat, rreth 79% e zgjedhësve të regjistruar arritën të ushtronin të drejtën e votës, me zarfet që mbërritën brenda afatit ligjor.

Rekomandime / Opinione

- Çfarë rregullimesh të mëtejshme ligjore apo proceduriale mendoni se duhet të zbatohen në votimin e diasporës ?

- A duhet të përdoren format të tjerat ë votimit (votimit direkt në përfaqësi diplomatike apo votimi elektronik, posta publike)
- A mendoni se duhet të lejohet përfaqësimi i Diasporës në një zonë të vecantë (deputetët përkatës – Zona e 13-të zgjedhore)

Fushata elektorale dhe përdorimi i burime shtetërore

Përdorimi i burimeve shtetërore në zgjedhje krijon kushte të pabarabarta për subjektet politike duke dëmtuar standardet zgjedhore, cilësinë e demokracisë si dhe funksionimin e institucioneve publike. Rekomandimet e raporteve të OSBE/ODIHR dhe organizatave të tjera monitoruese theksojnë shqetësimin në rritje për të adresuar rolin e aparaturës së administratës qendrore dhe vendore në fushatat zgjedhore.

Problematikat

Problematikat e konstatuara në zgjedhjet e 11 majit me përdorimin e burimeve shtetërore përfshinë iniciativa për lehtësi fiskale apo falje gjobash nga administrata qendrore dhe lokale gjatë periudhës së fushatës, rritje e pagave dhe pensione (marrëveshja me Italinë), pjesëmarrje të zyrtarëve publikë në aktivitete fushate gjatë orarit zyrtar të punës, prezantimit të projekteve publike si arritje partiake (përrurimi i aeroportit të Vlorës tunelit të Murritzit etj) duke prishur neutralitetin institucional.

Rekomandime nga raportet ISP/ASP

Më poshtë renditen disa rekomandime në drejtim të përmirësimit të kuadrit rregullator dhe institucional:

- **Shtrirja e kufizimeve për vendimmarrjen që sjell përfitime** për qytetarët në periudhën parazgjedhore edhe në zgjedhjet vendore duke evituar standarde të dyfishta mes zgjedhjeve të përgjithshme dhe atyre lokale.
- Detyrimi për plotësimin me **akte dytësore dhe rregullore të brendshme të Këshillit të Ministrave** për të përcaktuar qartësisht ndarjen mes detyrës dhe angazhimit politik të ministrave që kandidojnë apo drejtojnë fushatën partiake. Kodet e Sjelljes dhe hartimi i Praktikave të mira mund të shërbejnë si një nxitje e mëtijshme për kontrollin e përdorimit të aseteve publike.
- Monitorimi i **kufizimeve për emërimet/largimet në administratë** gjatë fushatës zgjedhore nga një autoritet pranë KQZ (nivel nënkryetari) ose strukturë e posaçme, e propozuar nga opozita ose përfaqësues i shoqërisë civile. Struktura aktuale e menaxhimit të administratës shtetërore, e bën të pamundur kontrollin e plotë të

situatës, ndërkohë që task-forca apo format e kontrollit të brendshëm institucional janë provuar jo efikase.

- Përfshirja e Kontrollit të Lartë të Shtetit në kontrollin e kufizimeve mbi përdorimin e aseteve publike në fushatë si shfrytëzimi i automjeteve zyrtare, stafit të kabinetit, apo dhe vendime si reduktime në mbledhjen e detyrimeve apo falje të sanksioneve administrative.
- Rritja e transparencës së institucioneve publike nëpërmjet **raportimit post zgjedhor apo vjetor pranë Kuvendit mbi shpenzimet** për udhëtimet, biletat, dietat, karburantin etj. nga anëtarët e Këshillit të Ministrave dhe zyrtarët e tjerë të lartë që kandidojnë në zgjedhje, sipas praktika më të mira të Open Data dhe Open Government.

REKOMANDIMET E FOKUS GRUPIT

Pjesëmarrësit në fokus grup prezantuan eksperiencat e tyre gjatë fushatës elektorale dhe ditës së zgjedhjeve si dhe opinionet e tyre për çështjet kryesore të identifikuara si problematike dhe me ndikim në përfaqësimin politik.

- **SISTEMI ZGJEDHOR**

Sistemi aktual ka vërtetuar se nuk është gjithëpërfshirës dhe favorizon vetën forcat e mëdha. Mund të shihet mundësia për të patur një zonë zgjedhore kombëtare duke synuar një përfaqësim sa më të mirë të votuesve.

- **LISTA E MBYLLUR**

Zgjedhjet e 11 maj dëshmuar se edhe në listën e hapur vota u orientua nga drejtuesit e partive duke mos siguruar vullnetin e lirë për zgjedhësit dhe konkurrencën e duhur të kandidatëve.

- **MANDATI I DEPUTETIT**

Deputetët që humbasin mandatin apo preken nga ligji i dekriminalizimit të mos zëvendësohen nga kandidatë të forcës politike. Ky kusht mund të kufizojë kandidimin e figurave problematike nga partitë.

- **KUOTAT GJINORE**

Përshtatja e parashikimeve ligjore që shpërndarja e kuotave gjinore të zhvillohet në mënyrë më eficiente dhe të mbrohet gjithmonë gjinia më e diskriminuar.

- **DIGJITALIZIMI**

Duke marrë në konsideratë benefitet, e sidomos efikasitetin që ofron teknologjia ndoshta duhet që sistemet teknologjike të përfshihen në procesin zgjedhor, me fokus të veçantë ditën e votimit dhe procesin e numërimit.

- **NDIKIMI I GRUPEVE KRIMINALE**

Konstatohet përsëri se grupet kriminale ose krimi i organizuar ndikojnë në fushatat zgjedhore, duke financuar fushatat e kandidatëve për deputet, ose dhe në proceset zgjedhore duke kryer shkelje të ndryshme të ligjeve.

- **PËRFSHIRJA E SPAK/BKH**

Strukturat e Posaçme nuk u mbështetën në terren nga policia lokale duke mos mundësuar parandalimin e shkeljeve ligjore dhe përfshirjen e personave të inkriminuar gjatë fushatës dhe ditën e zgjedhjeve. Duke shtuar këtu dhe faktin se koha e monitorimit nga SPAK dhe BKH ishte e shkurtër dhe në një terren thuajse të panjohur për problematikat apo grupimet e caktuara të cilat mund të ishin ndikuese në procesin zgjedhor.

- **NDËRHYRJET NË PROCESIN E VOTIMIT**

Konstatohen dhe faktohen përsëri shkelje të ndryshme gjatë ditës së votimit si votimit familjar apo patronazhimi i zgjedhësve. Masat dhe penalizmi vetëm në raste të pakta.

- **PATRONAZHISTËT**

Fenomeni i të kontaktuarit nga persona të ndryshëm gjatë periudhës zgjedhore ku herë nënkuptohet dhe herë kërkohet haptazi vota për një subjekt ose kandidatë politik. Dëshmi se i njëjti fenomen ishte prezent edhe te të afërmit emigrantë.

- **VOTIMI I DIASPORES**

Procesi u shoqërua me shkeljen e të drejtës për privatësi, ku individ kontaktoheshin nga parti politike ku pyeteshin nëse e kishin tërhequr zarfin me fletën e votimit ose a kishin votuar.

- **KUOTAT PËR DIASPORËN**

Sugjerohet që për diasporën të parashikohen mandate të posaçme në Kuvend dhe diaspora të votojë vetëm për këto kandidatë.

- **RAPORTIMI I MEDIAS**

Media u kufizua edhe më tej gjatë kësaj fushate për të ndjekur lirisht aktivitetet për shkak të “kasetave të gatshme”. Rekomandohet që Kodi Zgjedhor të mos penalizojë mediat nëse nuk publikojnë materiale e gatshme që u serviren nga partitë.

- **FUSHATA NË RRJETE SOCIALE**

Nga fushata zgjedhore e 2025 u konstatua që një pjesë e mirë e fushatës elektorale e secilës parti u krye në rrjete sociale (Instagram, tik tok, facebook, X, etj). Kjo praktikë nuk është e rregulluar dhe si e tillë do duhet të krijohet një bazë ligjore.

- **DEZINFORMIMI**

Gjatë fushatës elektorale dhe ditës së votimit u përhapën informacione të rreme për të intimiduar votuesit. Fenomeni u ndesh më shpesh në zonat rurale.

Maj 2025

Shtojca 1 – Lista e pjesëmarrësve në fokus grup

Nr.	Emri	Profili
1	Andrea Mazelliu	Lektor i së Drejtës, Ekspert i Politikave Publike
2	Aulona Hoxha	Drejtor Ekzekutiv, QENDRA ASET
3	Elvana Kurti	Konsulente programesh zhvillimi
4	Orjola Xhaholli	Eksperte për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Rinjve
5	Esiona Konomi	Gazetare
6	Osman Stafa	Gazetar
7	Klajdi Tozaj	Aktivist
8	Esmeralda Nexhipi	Juriste
9	Veip Kamberaj	Studiues
10	Subian Dalani	Jurist
11	Gevin Sherko	Student në Shkenca Politike
12	Dorina Bërdufi	Studiuese
13	Marinel Prenga	Specialist
14	Granit Sokolaj	Drejtor Ekzekutiv, Qendra ALERT
15	Doralda Tanellari	Instituti i Studimeve Politike
16	Juljana Bilbilaj	Instituti i Studimeve Politike